



Breaking News:

Pogradec/Goditet një tjetër rast i prerjes së paligjshme të pyjeve



17/07/2023

Vau i Dejës – Shpallet Në Kërkim Për Armëmbajtje Pa Leje, Shtetasi M. P., Dhe Punohet Për Kapjen E Tij.

Vau i Dejës

Shpallet në kërkim për armëmbajtje pa leje, shtetasi M. P., dhe punohet për kapjen e tij.

Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale arma e zjarrit tip automatik.

Pas një konflikti të çastit për parakalim të gabuar me automjet, midis shtetasve M. P., 28 vjeç dhe A. Gj., 23 vjeç, shtetasi M. P. është larguar dhe ka marrë armën e zjarrit tip automatik që mbante me vete.

Ndërhyrja e menjëhershme e shërbimeve të Komisarariatit të Policisë Vau i Dejës ka parandaluar përshkallëzimin e konfliktit midis këtyre dy shtetasve. Gjatë ndjekjes nga Policia, shtetasi M. P. ka hedhur armën e zjarrit dhe është larguar.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, ka nisur procedimi në gjendje të lirë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit", për shtetasit A. H., 21 vjeç, K. Sh., 19 vjeç, R. H., 30 vjeç dhe Xh. H., 25 vjeç, të gjithë banues në fshatin Barbullush, Vau i Dejës, pasi kanë tentuar të fshehin armën e zjarrit që mbante shtetasi M. P.

Vijon puna për kapjen e shtetasit M. P.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.



Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Durrës/Parandalohet përshkallëzimi i mëtejshëm i konfliktit në një familje

Pogradec/Goditet një tjetër rast i prerjes së paligjshme të pyjeve ▶